

VENDIM
Nr. 262, datë 10.4.2026

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIVITALIZIM URBAN I SHESHEVE TË PALLATEVE NR. 588, 712
ETJ., ‘ALEKS BUDA’, NË LAGJEN ‘5 MAJ’, ZONA KADASTRALE 8525”, BASHKIA
ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rivitalizim urban i shesheve të pallateve nr. 588, 712 etj., ‘Aleks Buda’, në lagjen ‘5 Maj’, zona kadastrale 8525’, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 7 791 408 (shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 791 408 (shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME , PRONE PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIVITALIZIM URBAN I SHESHEVE TË PALLATEVE NR. 588, 712 ETJ., ‘ALEKS BUDA’, NË LAGJEN ‘5 MAJ’, ZONA KASTRALE 8525”, BASHKIA ELBASAN

Nr.	TË DHËNAT E PRONARIT			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	TRUALL			VLERA TOTALE	
										Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)		
1	Shemsi Qazim Hatixhe Mimoza Arian Zyra Majlinda Nazmije Aferdita Luljeta Hilmi Kujtim Qemal Arta Rukije Faik Burbuqe Manushaqe Ahmet Albina Arta Jalldyz Maitap	Qazim Shemsi Shemsi Shemsi Shemsi Muharrem Shëfqet Shëfqet Shëfqet Shëfqet Qamil Qamil Qamil Qamil Qamil Ramazan Shkelqim Ramazan Ramazan	Curri Curri Curri Curri Curri Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Bedalli Qesja Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Bylykbashi Haxhiymeri Haxhiymeri Bylykbashi Bylykbashi	Elbasan	8525	18/95	Truall	169	169	169	14,192	2,398,448	2,398,448	
2	Arta Leonard Sokol	Beqir Kostandin Kostandin	Tollumi Tollumi Tollumi	Elbasan	8525	18/82	Truall	380	380	380	14,192	5,392,960	5,392,960	
Vlera totale													7 791 408	